



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-045

Prishtinë, më 11 janar 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 11 JANAR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Bilall Sherifi, Eshref Vishi dhe Skender Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE: Lejla Selimi,

Nga NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 dhjetor 2011,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 dhjetor 2011

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 dhjetor 2011, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të premtën, më 20 janar 2012, me këtë

R e n d d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për mandat të ri,
5. Ratifikimi i Marrëveshjes financiare në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim KfW për përmirësimin e sistemeve të ngrohtores qendrore,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë,
8. Shqyrtimi i parë i Projektregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullimin e tokës.

Gjithashtu, Kryesia vendosi që në ndërkohë, nëse përgatitet edhe ndonjë projektligj për shqyrtim të dytë, mund të radhitet për mbledhjen plenare më 20 janar 2012.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për mandat të ri

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Komisioni për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i formuar me vendimi të Kuvendit, më 22 prill 2011, në bazë të Rezolutës Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës. 7 prill 2011, ka kërkuar nga Kuvendi mandat të ri, me qëllim të amendamentimit të nenit 84 të Kushtetutës, që përcakton kompetencat e presidentit të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, Komisioni kishte shprehur gatishmërinë për rishikimin edhe të dispozitave kalimtare të Kushtetutës, që ndërlidhen me pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës.

Pastaj, kryetari hapi diskutimin lidhur me kërkesën e cekur më lart.

Lidhur me kërkesën e Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për mandat të ri, diskutuan: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, nënkryetarët e Kuvendit: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Glauk Konjofca dhe kryetarët e grupeve parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Ardian Gjini, diskutimet e tyre të plota janë dhënë në transkript.

Në fund, Kryesia vendosi që kërkesa e Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për mandat të ri, të radhitet për shqyrtim në mbledhjen plenare më 20 janar, si pikë e katërt e rendit të ditës.

3.2 Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur vizitën zyrtare të realizuar në Turqi

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, të realizuar në Turqi, prej 4 deri më 7 dhjetor 2011.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **12:25** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.